

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vlorë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROJEKT- VENDIM**  
**Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020**

**MBI PËRDORIMIN E FONDEVE TË BASHKISË VLORË PËR NDIHMËN NDAJ  
FAMILJEVE TË SHITESAVE NË NEVOJË, SI PASOJË E SITUATËS SË  
SHKAKTUAR NGA INFEKSIONI COVID-19**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 , datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ , neni 8, neni 9/1 pika 1/1 a dhe b, pika 1/3 c, nenet 10, 24, 40/4, 54/k; si dhe VKB nr.114 datë 27.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2020”; pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Vlorë;

**V E N D O S I**

1. Të miratojë dhënien e ndihmave ndaj 1500 familjeve të shtresave në nevojë, si pasojë e situatës së shkaktuar nga infeksioni COVID-19, bazuar në listat bashkëlidhur që disponon Sektori i Ndhmës Sociale në Bashkinë Vlorë në bashkëpunim me Rajonet/Njësitë Administrative.
2. Ndhimat që do të jepen sipas pikës 1 të këtij vendimi do të kenë vlerën prej 2,058 lekë për familje me një fond total prej 3,087,000 lekë dhe do të përmbajnë produktet sipas listës bashkëlidhur.
3. Cmimi i produkteve do të bazohet në cmimet njësi të kontratës të prokuruar gjatë veprimtarisë së Bashkisë Vlorë në vitin 2020, për furnizimin me ushqime të kopshteve dhe cerdheve.
4. Fondet që do të nevojiten për realizimin sipas pikës 1 dhe 2, do të mbulohen nga fondet e miratuara me VKB nr.114 datë 27.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2020” për furnizimin me ushqime të kopshteve dhe cerdheve, duke u bërë ndryshimi i destinacionit të përdorimit të ushqimeve.
5. Drejtoria Juridike në Bashkinë Vlorë (Sektori i Prokurimeve) të hartojë aneks kontratën/amendamentin në negociim me kontraktorin për kryerjen e furnizimit sipas pikës 2 dhe 4 të projektvendimit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

**KRYETARI**


**Dritan Leli**

Konceptoi:

Drejtori: T. Zanaj

Drejtori: D. Zëraj

Drejtori: I.Stasa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË

Vlorë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2020


**MIRATOHET**

**K R Y E T A R I**

**Dritan LELI**

**PREVENTIVI BLERJE USHQIME PËR VITIN 2020**

<b>USHQIME KOLONIALE</b>					
<b>Nr</b>	<b>EMERTIMI</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Cmimi</b>	<b>Vlera</b>
1	Sheqer i paketuar 1 kg	kg	2	75	150
2	Oris i paketuar 1 kg	kg	4	120	480
3	Vaj vegjetal	litra	2	140	280
4	Makarona spageti	kg	4	120	480
6	Mjell i paketuar 1 kg	kg	5	65	325
	<b>Shuma</b>				<b>1,715</b>
	<b>TVSH</b>				<b>343</b>
	<b>Totali</b>				<b>2,058</b>



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vlorë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2020

**RELACION**  
**MBI PËRDORIMIN E FONDEVE TË BASHKISË VLORË PËR NDIHMËN NDAJ**  
**FAMILJEVE TË SHITRESAVE NË NEVOJË, SI PASOJË E SITUATËS SË**  
**SHKAKTUAR NGA INFEKSIONI COVID-19**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 , datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ , neni 8, neni 9/1 pika 1/1 a dhe b, pika 1/3 c, nenet 10, 24, 40/4, 54/k; si dhe VKB nr.114 datë 27.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2020”, në kuadër të pandemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19, si dhe në vijim të planit të masave të ndërmarra nga shteti shqiptar, Bashkia Vlorë ka hartuar këtë projekt – vendim.

Në bazë të VKB nr.114 datë 27.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2020”, janë miratuar fondet përkatëse për prokurimin e ushqimeve për furnizimin e kopshteve dhe cerdheve. Aktualisht është lidhur kontrata me këtë objekt, por në situatën kur është mbyllur funksionimi i kopshteve dhe cerdheve për një afat trejavor dhe që premiset janë që do të zgjasë edhe më shumë në kohë, Bashkia Vlorë ka menduar që sasinë e planifikuar dhe që ka ngelur e do të ngelet e papërdorur e ushqimeve, ti ndryshojë destinacionin për ta përdorur për shtresat në nevojë.

Ky projekt vendim

- nuk ka për qëllim miratimin e fondeve të tjera shtesë, pasi ato janë miratuar me VKB nr.114 datë 27.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2020”,
- nuk ka për qëllim miratimin e cmimeve për njësi pasi ato tashmë janë përcaktuar mbi bazën kontratave të prokuruar dhe të nënshkruara në përputhje me legjislacionin në fuqi,
- nuk ka për qëllim dhënien e autorizimit për fillimin e procedurave të reja të prokurimit.

por ka për qëllim, dhënien e autorizimit Kryetarit të Bashkisë që fondet e përcaktuara për tu përdorur për furnizime për ushqime për nevoja të kopshteve e cerdheve, tashmë të përdoren për të njëjtat furnizime për shtresat në nevojë bazuar në listat që disponon Sektori i Ndihmës Sociale në Bashkinë Vlorë në bashkëpunim me Rajonet/Njësitë Administrative.

Sikurse është sqaruar edhe më lart, Bashkia ka nënshkruar kontratën për furnizimin me ushqime për vitin 2020, sasia e kontraktuar e të cilës nuk është konsumuar ende, por lind e nevojshme

negocimi me kontraktorin për të hartuar aneks kontratën apo amendamentin për kryerjen e furnizimit për këto mallra, pasi tashmë do të ndryshojë sasia e prokuruar, duke u rritur për 6 artikujt që janë parashikuar në preventiv dhe duke u ulur për artikujt e tjerë.

Nga sa më lart, ju ftojme të miratoni këtë projektvendim me qëllim vazhdimin e procedurave të mëtejshme.

**KRYETARI**

**Dritan LELI**

Konceptoi:

Drejtori: T. Zanaj

Drejtori: D. Zëraj

Drejtori: I.Stasa